



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

PROÇESVERBAL

Nr. 2, datë 20.01.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Janar, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:04

Data e mbajtjes së mbledhjes : 20.01.2022

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Rradhe

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve !

Të nderuar Këshilltarë! Të nderuar përfaqësues të bashkisë !

E deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak Durrës me mjete të komunikimit elektronik.

Kjo mbledhje është kërkuar nga Kryetarja e Bashkisë. Siç jeni vënë në dijeni me rrugë elektronike materialet ju janë dërguar aty.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën e këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok..... Adriana Hatellari ?.....

Eneida Marku (asistenca teknike) : Adriana ka një problem me adresën e skype, po më shkruan ndërkohë që është pro rendit të ditës por po ja u shkruan dhe me email.

Dorina Milja:ok... Jurgen Zaza..... prezentetj.....deri te Morena Boja.....

Atëherë Kryetar ke 32 këshilltarë që u dëgjuan online ke dhe 12 vota me email.

(p.s. *Votoi me email gjatë mbledhjes Morena Boja dhe Adriana Hatellari e cila për arsye teknike nuk votonte dot në chat të skype kështu që janë 31 vota nga këshilltarë online dhe 14 vota me email. Gjithsej 45 vota në mbledhje*)

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Atëherë meqë kuorumi është i pranishëm kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Sot në rend dite kemi vetëm 1 pikë, e cila është:

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.3,5,7 RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR.1, RRUGA “DEMOKRACIA”, PALLATI NR.2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR.6, RRUGA “MILENIUMI” DHE PALLATI NR.4, RRUGA “MINIERËS” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
---	--

Kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?....

Nuk kemi, atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*)...

Kundra?Apstenim?.....

Ju lutem të votojë kush nuk ka votuar ende.

Eneida mund të ma konfirmosh është mbyll procesi i votimit?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Jo ende, janë duke votuar kolegët. Deri më tani të gjithë kanë votuar pro rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Ju lutem kush nuk ka votuar të votojë.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Atëherë kolegët kanë përfunduar procesin e votimit.

Ani Dyrmishi : Atëherë faleminderit .

Me të gjitha votat pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1** dhe të vetme të këtij rendi, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon për pikën 1 për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar ! Përshendetje të gjithëve !

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit!

Komente përsa i përket pikës, ka nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 1 dhe të vetme të rendit të ditës?*(ndërkohë qetësi... votohet në chat)* .

Kundra? Apstenim?.....

Ju lutem, të votojë kush nuk ka votuar ende.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Votimi ka përfunduar. Atëherë kolegët kanë votuar pro pikës 1. Vetëm një sekond se kemi dhe një koleg që po voton.

Ani Dyrmishi: Atëherë ka më Eni që po votojnë ?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Jo

Ani Dyrmishi: Atëherë votimi ka përfunduar .

Me të gjitha votat pro miratohet pika 1 dhe e vetme e rendit të ditës.

Ju faleminderit të gjithëve për pjesmarrjen. Për mbledhjet e ardhshme ose të rradhës do të njoftoheni nga Sekretaria e Këshillit.

Ju falenderoj të gjithëve dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 3(tre) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funksionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI